UDHËZIM
Nr. 15, datë 13.3.2025

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 25.7.2018, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 34, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 25, datë 25.7.2018, "Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor", bëhen shtesat si më poshtë:

a) Pas pikës 5, të kreut 3, shtohen pikat 5/1 dhe 5/2, me përmbajtje, si më poshtë:

"*5/1. Në institucionet publike të arsimit parauniversitar, në juridiksionin e Bashkisë Shkodër, Divjakë, Berat dhe Kolonjë për zbatimin e projektit pilot të përfshirjes së tyre në ushtrimin e përgjegjësive në fushën e arsimit parauniversitar, bordi përbëhet nga shtatë veta: një mësues, një prind, një nxënës, një pjesëtar tjetër i komunitetit dhe tre përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse. Kur në bord nuk ka nxënës, ai përbëhet nga një mësues, një prind, dy pjesëtarë të tjerë të komunitetit dhe tre përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.".*

"5/2. Përbërja e bordit në institucionet publike të arsimit parauniversitar, sipas pikës 5/1 të këtij udhëzimi, është sipas kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe bashkisë përkatëse.".

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Divjakë, Bashkia Kolonjë dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin e këtyre bashkive.".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Orjana Osmani